

Institucioni i Parasë Elektronike EasyPay SH.P.K **Kushtet dhe Afatet e Ofrimit të Shërbimeve EasyPay**

1. Hyrje

Ky dokument përbën një marrëveshje të lidhur midis Easypay Sh.p.k., e regjistruar pranë QKB me (NIPT) K61730019P, me seli në adresën: Rruga Vëllezërit Hobdari, Godina Nr 15, Tiranë e liçensuar nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet licenses nr. 35/1, date 27.11.2024 për të mundësuar pagesat në rrugë elektronike në Republikën e Shqipërisë dhe Klientëve përkatës të EasyPay Sh.p.k., e cila parashikon Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të përdorimit të shërbimeve financiare të Institucionit të Parasë Elektronike EasyPay Sh.p.k (në vijim referuar si 'EasyPay') nga Klientët EasyPay (në vijim referuar si "Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme" ose "Kushte të Përgjithshme"). Në çdo rast, për të përdorur Aplikacionin EasyPay, Klienti pranon të respektojë edhe kushtet e ofrimit të shërbimit të palëve të treta të cilët janë të lidhur ngushtë me shërbimet e pagesave të ofruara në aplikacion (kur kjo është e nevojshme).

Klienti duhet të lexojë dhe kuptojë plotësisht këto Kushte dhe Afate për përdorimin e Shërbimeve EasyPay dhe nëse nuk është dakord me to, nuk duhet të procedojë me regjistrim, nënshkrimin e kësaj kontrate apo kryerjen e shërbimeve EasyPay.

Me pranimin dhe nënshkrimin e këtyre Kushteve dhe Afateve, Klienti pranon se për të mundësuar dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave të autoriteteve, EasyPay mund të kërkojë informacion shtesë ose dokumentacion mbështetës / shtesë nga Klienti me qëllim parandalimin apo zbulimin e veprimtarive kriminale (mashtrimi, pastrimi i parave, etj) ose për qëllime marketingu.

2. Përkufizime

- a. "Shërbimi i Pagesës EasyPay": për qëllim të kësaj Kontrate ka kuptimin sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 55/2020 "Për Shërbimet e Pagesave".
- b. "Llogaria EasyPay": është llogaria e parasë elektronike të Klientit të EasyPay e cila konsiderohet e hapur menjëherë pas përmbylljes së procesit të regjistrimit të tij në kanalet digjitale. Llogaria EasyPay kreditohet nga vetë Klienti EasyPay (i) nëpërmjet krijimit të parasë elektronike në vlerë të barabartë me paranë fizike të depozituara tek një Agjent EasyPay (ii) me debitim direkt nga llogaria bankare e Klientit, (iii) kryerjes së një transaksioni rimbushës nga Karta e Debitit ose Kreditit (iv) transferte bankare nga llogaria e klientit te llogaria e Easypay prane nje banke te nivelit te dyte. Në vijim kjo llogari përdoret nga Klienti për kryerjen e Transaksioneve të Pagesave.
- c. "Transaksioni i Pagesës" përbën veprimin financiar – i iniciuar nga Klienti ose për llogari të tij, që konsiston në debitimin e llogarisë EasyPay (fondet) të blerësit dhe kreditimin e llogarisë të përfituesit (tregtarit, institucionit, klientit IPE përfitues) për vlerën e mallit/shërbimit të përzgjedhur për t'u paguar nga Klienti EasyPay, pavarësisht detyrimeve të tjera midis Klientit / Paguesit dhe përfituesit të pagesës
- d. "Para elektronike" janë instrumente të pagesave elektronike të emetuara nga EasyPay që i mundësojnë mbajtësit të tyre të kryejë pagesa elektronike.
- e. "Blerja e Parasë Elektronike" është blerja nga Klienti me para 'cash' pranë një Agjenti EasyPay, ose me transaksion pagese nëpërmjet kartës së Kreditit/ Debitit apo direkt nga llogaria bankare (debitim direkt) kundrejt shumave të barazvlefshme, të Parasë Elektronike që kreditohet në llogarinë e Klientit.
- f. "Agjent" është personi tregtar, fizik ose juridik, i kontraktuar nga EasyPay për të ofruar në emër dhe për llogari të EasyPay, Shërbimin EasyPay në Republikën e Shqipërisë.
- g. "Pikë Shitje" është çdo dyqan, njësi tregtare e shitjeve me pakicë që drejtohet nga një Agjent.
- h. "Debitim" është reduktimi i fondeve të llogarisë së Klientit EasyPay si pasojë e një Transaksion Pagese të kryer nga ana e Klientit EasyPay.
- i. "Kreditim" është çdo transaksion hyrës në llogarinë e Klientit EasyPay që përkthehet në rritje të vlerës së parasë elektronike në llogarinë EasyPay dhe që kryhet me para elektronike, siç verifikohet nga EasyPay.
- j. "Faqja e Internetit EasyPay" i referohet faqes zyrtare të Internetit të EasyPay Sh.p.k. përkatësisht www.easypay.al.
- k. "Monedha" është monedha shqiptare LEK, me të cilën operon EasyPay. Çdo monedhë tjetër konvertohet bazuar në kursin ditor të përditësuar nga Banka e Shqipërisë dhe llogariten nga platforma si vlera të barazvlefshme në monedhën shqiptare LEK.
- l. "Klienti" është individ, personi fizik ose juridik nënshkrues/ pranues i kësaj Kontrate dhe Kushteve dhe Afateve të Përdorimit të Shërbimeve EasyPay, në emër të të cilit është regjistruar një llogari për përdorimin e Shërbimeve EasyPay.
- m. "Dërgues" është çdo Klient i regjistruar në EasyPay, individ, person juridik ose person fizik i cili në çastin e regjistrimit është mbi 18 vjeç, ka nënshkruar Kontratën për regjistrim në EasyPay dhe ka pranuar Kushtet dhe Afatet e Përdorimit të llogarisë EasyPay me qëllim për të përfituar nga Shërbimi i Pagesës EasyPay, nëpërmjet çfarëdolloj forme të lejuar në këtë Kontratë duke përfshirë, ndër të tjera, shkarkimin dhe aktivizimin e Aplikacionit EasyPay në aparatin e tij celular.
- n. Kushtet e Përdorimit" është tërësia e këtij dokumentacioni i cili përbën Kushtet dhe Afatet e Përdorimit të Shërbimeve EasyPay siç mund të ndryshohen herë pas here.

- o. "Kontrata" është tërësia e këtij dokumentacioni i cili përbën Kushtet dhe Afatet e Përdorimit të Shërbimeve EasyPay së bashku me Formën e Kërkesës për Regjistrim për Shërbimet EasyPay, Aneksin e Limiteve të aplikueshme në Llogarinë EasyPay, listat e çmimeve dhe tarifat e aplikueshme, si dhe kushtet dhe afatet e tjera të njoftuara herë pas here dhe të detyrueshme sipas Legjislacionit në Fuqi dhe rregulloreve të miratuara në zbatim të tij, të cilat të gjitha së bashku përbëjnë Kontratën ndërmjet EasyPay Sh.p.k. dhe Klientit EasyPay.
- p. "Password" është fjalëkalimi që shërben për të verifikuar identitetin e përdoruesit EasyPay që Klienti zgjedh për të aksesuar dhe përdorur Llogarinë EasyPay.
- q. "Kredenciale" (password, username, kontakt, pyetje sigurie) janë tërësia e të dhënave identifikuese të klientit të krijuara nga vetë ai në momentin e regjistrimit ose të përditësuar në vijim për shkak të skadencave të afateve kohore ose harrimit dhe që shërbejnë për aksesin e sigurtë nga ana e klientit të shërbimeve digjitale EasyPay.
- r. Autentifikim" është procedura që i mundëson EasyPay verifikimin e identitetit të një përdoruesi të shërbimit të pagesës ose vlefshmërisë së përdorimit të një instrumenti specifik pagese, duke përfshirë edhe përdorimin e të dhënave të personalizuar të sigurisë së përdoruesit.
- s. Autentifikim i thelluar i klientit" është një autentifikim i bazuar në përdorimin e dy ose më shumë elementeve të kategorizuara, si: njohuri (diçka që vetëm përdoruesi e di), posedim (diçka që vetëm përdoruesi e zotëron) dhe qenësi (diçka që përdoruesi është), që janë të pavarura, në kuptimin që shkelja e njëres nuk kompromenton besueshmërinë e të tjerave dhe që është projektuar në mënyrë të tillë që të mbrojë konfidencialitetin e të dhënave të autentifikimit
- t. "Shërbimet EasyPay" janë shërbimet që ofrohen, reklamohen, administrohen dhe zotërohen ekskluzivisht nga EasyPay për emetimin dhe transferimin e Parasë Elektronike ndërmjet Klientëve në bazë të Urdhrave të Transfertave duke përfshirë regjistrimin e të gjithë Transaksioneve, verifikimin dhe konfirmimin e të gjitha Transaksioneve të përfunduara dhe përditësimin e të dhënave të Llogarisë EasyPay së Klientit.
- u. "Urdhërpaguesa" do të thotë një urdhër nga një pagues ose përfitues pagese për ofruesin e tij të shërbimit të pagesave, që kërkon ekzekutimin e një transaksioni pagese.
- v. "Të Dhëna Personale" janë çdo informacion në lidhje me një person , sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar përkatës.
- w. "Aplikacioni EasyPay" është aplikacion i ndërtuar ekzkluzivisht nga EasyPay Sh.p.k, i cili shkarkohet ne sistemet IOS, Android dhe Windows dhe i ofron Klientit EasyPay mundësinë e aktivizimit të llogarisë EasyPay në aparatin e tij/ saj celular duke e mundësuar për të marrë dhe të këmbyer vlera monetare në para elektronike duke kryer shërbime të ndryshme pagesash, abonimesh, kontrolli balance, depozitimi, debitim direkt. etj.
- x. "Shërbimi i Klientit" është Qendra e Shërbimit të Kujdesit ndaj Klientit që telefonohet në [00355 42 264 982](tel:0035542264982).

3. Kërkesë për Regjistrim në EasyPay

Klienti mund të regjistrohet për përdorimin e Shërbimeve EasyPay në platformën mobile ose web në faqen zyrtare të EasyPay (www.easypay.al).

Me qëllim regjistrimin, Klienti duhet të japë të plotë dhe të sakta informacionet e mëposhtme:

- (i) *Emër, Mbiemër*
- (ii) *Numrin personal të identifikimit ose Numrin e Dokumentit të Identifikimit*
- (iii) *Adresën e plotë të banimit / postare*
- (iv) *Adresën e postës elektronike (e-mail)*
- (v) *Datën e lindjes*
- (vi) *Vendlindjen*
- (vii) *Kombësinë*
- (viii) *Shtetin*
- (ix) *Vetedeclarim nëse klienti është PEP ose jo*
- (x) *Profesioni*
- (xi) *Numrin kontakti të telefonit celular*
- (xii) *Vetedeclarim i Nr e Takses /Vendbanimit tatimor etj per klientët jo rezident*
- (xiii) *Emrin e përdoruesit të përzgjedhur nga Klienti dhe fjalëkalimin që do të përdoret për llogarinë EasyPay.*

Si dhe te pranoje të gjithë Kushtet dhe Afatet e Ofrimit të Shërbimeve EasyPay si dhe pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale në fushën përkatëse.

Për qëllim të identifikimit dhe verifikimit, Klienti do të dorëzojë të dhënat dhe dokumentet e kërkuara nga EasyPay (një pasaportë, një kartë identiteti, etj) te cilat do të përpunohen dhe ruhen nga EasyPay sipas përcaktimeve në ligj dhe akte nënligjore në fuqi.

EasyPay ruan të drejtën që, në përputhje me rregulloret e brendshme të EasyPay dhe Legjislacionin e Zbatueshëm, të refuzojë aplikimin e një personi që dëshiron të bëhet Klient EasyPay.

Me regjistrimin në Shërbimin EasyPay dhe aktivizimin e Llogarisë EasyPay, pasi të ketë zgjedhur një fjalëkalim personal, Klienti EasyPay do të ketë të drejtë të përdorë menjëherë Shërbimet EasyPay në Aplikacionin EasyPay, në faqen zyrtare EasyPay ose në mjete të tjera elektronike të vëna në dispozicion nga EasyPay.

Çdo Kontratë konsiderohet e lidhur dhe hyn në fuqi që nga momenti kur Klienti nënshkruan Kontratën fizikisht pranë çdo Agjenti EasyPay ose elektronikisht në platformën e EasyPay.

4. Proçedura e kryerjes së pagesës në rrugë elektronike

Për të kryer një pagesë në rrugë elektronike, Klienti duhet të jetë mbi moshën 18 vjeç dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Regjistrimi është hapi i parë që duhet të kryejë Klienti që dëshiron të kryejë një pagesë nëpërmjet përdorimit të Aplikacionit EasyPay ose nëpërmjet faqes zyrtare të internetit www.easypay.al.

Fjalëkalimi i vendosur nga Klienti në momentin e Regjistrimit, është personal dhe duhet të ruhet i fshehtë nga Klienti. Klienti do të ketë akses në të dhënat e tij personale në hapësirën e Klientit ose në rast se do të kryejë një pagesë, Klienti duhet të identifikohet paraprakisht nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit, duke patur parasysh se fjalëkalimi nuk shërben për kryerjen e pagesave.

Klienti kryen pagesën nëpërmjet procedurës së përshkruar në faqen e internetit ose në Aplikacionin EasyPay dhe konfirmon përmbledhjen e detajuar të kësaj pagese, e cila përmban të dhëna mbi produktin apo shërbimin, dhe çmimin e tij, tarifat/komisionet dhe të dhënat identifikuese të përfituesit.

Është përgjegjësi e Klientit të sigurohet që të dhënat në formularin e transaksionit/urdhërpagesës janë vendosur saktë. Çdo gabim nga ana e Klientit mund të rezultojë në transferim të pasuksesshëm ose të vonuar. EasyPay nuk mban përgjegjësi për asnjë humbje që mund të shkaktohet Klientit nga hedhja e te dhënave të pasakta nga Klienti.

Të dhënat sekrete/konfidenciale/sensitive të kartave bankare mirëmbahen dhe mbrohen nga banka lëshuese ose procesori i pagesave me karta. EasyPay nuk ruan asnjë të dhënë sekrete/konfidenciale/sensitive të kartave bankare të përdorura nga klienti gjatë kryerjes ose përdorimit të shërbimeve të pagesave EasyPay.

Vecanërisht për shërbimin e inicimit të pagesave dhe shërbimin e informimit të llogarisë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 55/2020 "Për Shërbimet e Pagesave", për të urdhëruar një transaksion inicimi pagese ose për të aksesuar shërbimin e informimit të llogarisë klienti duhet të inputojë të gjitha kredencialet e sigurisë të krijuara në momentin e regjistrimit. EasyPay nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi nëse në llogarinë përkatëse të Klientit kryen pagesë një person tjetër i cili është vënë në posedim të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit me apo pa dijeninë e Klientit përkatës në rast se vërtetohet se kjo nuk ka ndodhur për faj të EasyPay.

Verifikimi i të dhënave të Klientit dhe dhënia prej tij e numrit e të dhënave të llogarisë elektronike EasyPay apo të kartës bankare, përbëjnë nënshkrim dhe pranim të shprehur të të gjitha transaksioneve të kryera nga ana e Klientit në faqen e internetit të EasyPay apo në Aplikacionin EasyPay. EasyPay nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi nëse llogaria EasyPay apo karta bankare të dhënat e së cilës janë vendosur me qëllim kryerjen e pagesës është një llogari apo kartë e vjedhur ose e deklaruar e humbur, në rast se banka përkatëse konfirmon pagesën.

EasyPay nuk mban përgjegjësi për mosfunksionimin e faqes së internetit apo Aplikacionit EasyPay, që mund të vonojë ose të mos lejojë kryerjen e porositve në rrugë elektronike, për shkak të ngjarjeve përtej kontrollit të arsyeshëm të EasyPay apo për shkak të punimeve të mirëmbajtjes të kryera në faqen e EasyPay ose në Aplikacionin EasyPay përkatës. Klienti EasyPay do të paguajë Tarifat e zbatueshme për përdorimin e Shërbimeve EasyPay dhe këto Tarifa do të zbriten direkt nga Llogaria EasyPay përkatëse.

5. Fondet në Llogari

Fondet në llogari janë kartëmonedha dhe monedha fizike në monedhën shqiptare LEK dhe ose Euro të mbajtura për Klientin në një llogari të cilat konvertohen në para elektronike dhe transferohen në llogarinë e klientit. Ajo përfaqëson vlerën monetare në llogarinë e Klientit që ruhet në mënyrë elektronike si Para Elektronike për kryerjen e pagesave. Fondet në llogari e klientit nuk konsiderohen të jenë depozita sipas skemës së garancisë së depozitave ose me mjete të tjera të ngjashme për sigurimin e depozitave. EasyPay nuk do të paguajë interes për fondet në llogari të klientit. Klienti mund të tërheq fondet nga Llogaria e cila është rimbushur me ane të transferimit të fondeve nga llogaria bankare.

6. Transaksionet dhe shërbimet e ofruara për mbajtësin e Llogarisë EasyPay

Të gjitha Debitimet nga Llogaria e Klientit EasyPay ose Kreditimet e llogarisë EasyPay nga llogaritë e mbajtura në institucionet e tjera financiare ose karta bankare, do të kryhen sipas transaksioneve të autorizuar pas regjistrimit të kredencialeve të sigurisë të krijuara nga Klienti gjatë regjistrimit fillestar ose përditësimeve në vijim si dhe pas aplikimit të kushteve të autentifikimit të thelluar. Përpara çdo Transaksioni debiti, kreditimi apo pagesë me para fizike ose digjitale

ose elektronike që mund të kërkohej nga klienti, do të kryhet procesi i verifikimit të identitetit të klientit me prezencë fizike, verifikim digjital ose të kredencialeve të regjistruara sipas rastit dhe tipit të transaksionit. Letërnjoftimi ose pasaporta e paraqitur do të regjistrohet nga Agjenti EasyPay për çdo Transaksion me para në dorë 'cash'.

Klienti nuk mund të kryejë Transaksione nga Llogaria EasyPay përkatëse, në rast se nuk ka mjaftueshëm balance të parasë elektronike në Llogarinë EasyPay për të mbuluar vlerën e transaksionit dhe tarifat e aplikueshme.

Çdo veprim përfundon kur Klienti jep konfirmimin e tij për ekzekutimin e një transaksioni. Në të gjitha rastet procesi i kryerjes së një Transaksioni shoqërohet me minimalisht 2 (dy) hapa konfirmimi nga Klienti, deri në ekzekutimin final të transaksionit. Në shërbimet e pagesave Klienti merr mandat fizik ose elektronik, ose faturë elektronike në adresën e tij të postës elektronike (e-mail), ndërkohë që mund të marrë dhe konfirmimin me mesazh (SMS) menjëherë nga ofruesi i shërbimit.

Me hapjen e Llogarisë EasyPay, Klienti do të jetë në gjendje të kryejë **Transaksionet** e mëposhtme:

i. Transaksion Kreditimi që konsiston në:

- *Blerje të parasë elektronike me para në dorë 'cash', drejtpërdrejtë pranë një Agjenti EasyPay në këmbim të një shume të barazvlefshme që do të kreditohet në Llogarinë EasyPay të Klientit;*
- *Transferim fondesh nga llogaria bankare apo karta kreditit/ debitit drejt Llogarisë EasyPay.*

ii. Transaksion Debitimi që konsiston në:

- *Pagesa utilitare (Uje, Energji Elektrike, Internet, Taksa dhe Tatime);*
- *Pagesa kopshtesh ose shkollash;*
- *Pagesa e-commerce;*
- *Pagesa biletash dhe eventesh;*
- *Pagesa Digitalb;*
- *Pagesa Mikrokredi;*
- *Etj (sipas njoftimeve promocionale ose informuese të dërguara në adresat e kontaktit).*

iii. Shërbimi i inicimit të një transaksion pagese;

Shërbimi inicimit të një transaksioni pagese nga aplikacioni EasyPay ofrohet vetëm për klientët e nivelit 2 (ose më shumë) sipas Aneksit I, duke debituar llogarinë e klientit të mbajtur pranë një institucioni tjetër financiar dhe mund të ofrohet vetëm për llogaritë bankare në bankat me të cilat EasyPay disponon marrëveshje për këtë shërbim të listuara në faqen zyrtare www.easypay.al ose në informacionin e paraqitur në aplikacion. Gjithashtu për ofrimin e shërbimit klienti duhet të japi aprovimin/pelqimin e tij sipas deklaratës përkatëse. Në rast refuzimi të nënshkrimit të deklaratës nga klienti ose përzgjedhjes së opsionit të refuzimit të dhënies së autorizimit, atëherë ky shërbim nuk do të ofrohet nga EasyPay për klientin. Në rast se në një moment të dytë klienti dëshiron të autorizoj EasyPay për të përfutur këtë shërbim mund të kontaktojë EasyPay në adresën info@easypay.al ose në numrat e telefoni të suportit të klientëve ose mund të paraqitet pranë një pike EasyPay për të nënshkruar deklaratën e autorizimit.

Ky shërbim ofrohet në mbështetje të parashikimeve të kuadrit rregullator në lidhje me autentifikimin e thelluar, në zbatim të të cilit përveç të tjerash kërkohej nga klienti autentifikimi i tij nëpërmjet aplikacionit EasyPay sa here që kërkohej të kryhet një transaksion inicimin pagese.

iv. Shërbimi i informimit të llogarisë;

Shërbimi i informimit të llogarisë ofrohet vetëm për klientët e nivelit 2 (ose më shumë) sipas Aneksit I dhe përfshin shërbimin e ofruar brënda aplikacionit EasyPay për informimin në bazë të kërkesës së klientit mbi numrin, balancën, institucionin financiar mbajtës të llogarisë për të cilët klienti kërkon të informohet dhe autorizon duke dhënë pelqimin EasyPay sipas deklaratës përkatëse. Ky autorizim mbetet në fuqi deri në zgjidhje të kontratës ose deri në revokim nga klienti.

Në rast refuzimi të nënshkrimit të deklaratës nga klienti ose përzgjedhjes së opsionit të refuzimit të dhënies së autorizimit, atëherë ky shërbim nuk do të ofrohet nga EasyPay për klientin. Në rast se në një moment të dytë klienti dëshiron të autorizoj EasyPay për të përfutur këtë shërbim mund të kontaktojë EasyPay në adresën info@easypay.al ose në numrat e telefonit të suportit të klientëve ose mund të paraqitet pranë një pike EasyPay për të nënshkruar deklaratën e autorizimit.

Ky shërbim ofrohet në mbështetje të parashikimeve të kuadrit rregullator në lidhje me autentifikimin e thelluar, në zbatim të të cilit përveç të tjerash kërkohej nga klienti autentifikimi i tij nëpërmjet aplikacionit EasyPay sa here që kërkohej të kryhet një shërbim informimi të llogarisë.

v. Transferta P2P nga një klient IPE tek një tjetër;

Shërbimi i transfertave P2P mund të ofrohet vetëm për klientët e parasë elektronike të nivelit 2 (ose më shumë), pa komision, sipas specifikimeve të Aneksit I bashkëlidhur kësaj kontrate. Ky shërbim bën të mundur transferimin e një pjese të balancës së parasë elektronike të një klienti tek një klient tjetër EasyPay nëpërmjet shërbimit të ofruar në aplikacionin EasyPay.

vi. Konvertimi i balancës së parasë elektronike;

Shërbimi i konvertimit të balancës së parasë elektronike nga një monedhë e caktuar në një monedhë tjetër ofrohet vetëm për klientët e parasë elektronike të nivelit 2 (ose më shumë), bazuar në kursin ditor të këmbimit të publikuar në faqen zyrtare www.easypay.al ose në aplikacionin EasyPay. Kursi i këmbimit i aplikuar gjithashtu duhet aprovuar nga klienti në momentin e kryerjes së transaksionit në aplikacionin EasyPay para procesimit ku do të paraqitet gjithashtu një përlogaritje e vlerës së konvertuar pas këmbimit.

7. Udhëzime mbi procedurën e paraqitjes së ankesave dhe zgjidhjen e tyre

Klientët EasyPay mund të paraqesin ankesë për çështje të ndryshme të lidhura me Shërbimet EasyPay sipas mënyrave në vijim:

- Telefonatë në numrin e Shërbimit për Klientët 00355 42 264 982. Shërbimi është i disponueshëm 09:00-21:00, 6 (gjashtë) ditë në javë, nga e hëna në të shtunë.
- Pikat e Agjentëve të autorizuar të shoqërisë EasyPay Sh.p.k. gjatë orëve të punës së tyre.
- Ankesë me shkrim të dërguar përmes shërbimit të postës në adresën zyrtare Shoqëria Easypay Sh.p.k., Rruga Vëllezërit Hobdari, Godina Nr 15 , Tiranë.
- Postë elektronike duke dërguar ankesën në adresën e e-mail: info@easypay.al.

Afati kohor për njoftimin e Klientit në lidhje me përfundimet e analizës së ankesës është jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune pas marrjes së saj në një nga mënyrat e përshkruara si më sipër. Në raste të jashtëzakonshme kur përgjigja ose përfundimet e analizës nuk mund të jepen brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, EasyPay njofton Klientin mbi arsyet e vonës dhe afatin deri kur do të kthehet përgjigje (në cdo rast jo më vonë se 35 ditë pune nga regjistrimi i ankesës).

EasyPay me qëllim vërtetimi dhe arkivimi të ankesës së klientit mund ti kërkojë klientit të paraqitet fizikisht për nënshkrimin një deklarate në lidhje me ankesën e paraqitur. EasyPay do të mbajë një regjistër të veçantë për ankesat e paraqitura dhe përgjigjet e dhëna, të shënuara me numër reference. Ky regjistër përmban ankesat, kërkesat apo sugjerimet me shkrim të Klientëve dhe përgjigjet, vendimet dhe masat e marra nga EasyPay në lidhje me këto ankesa. Klienti në cdo rast si pasojë e mosmarrëveshjeve me EasyPay mund të paraqesë pretendimin e tij pranë njësisë së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 92 dhe Nenin 93 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe procedurën e vendosur nga Banka e Shqipërisë.

8. Udhëzime në lidhje me procedurën e anulimit dhe rimbursimit të Transaksioneve

Klienti EasyPay mund të anullojë një urdhërpagese deri në momentin kur urdhërpagesa nuk është konfirmuar /autorizuar duke ndërprerë seancën dhe duke mos konfirmuar (autorizuar) urdhërpagesën.

Klienti EasyPay pranon se mund të kërkojë anulimin e një transaksioni të kryer nga llogaria e tij/ saj EasyPay duke telefonuar Shërbimin për Klientët EasyPay në numrin [00355 42 264 982](tel:0035542264982), duke shkruar në adresën e email: info@easypay.al ose duke u paraqitur pranë një pike EasyPay për të plotësuar një deklaratë me shkrim, deri në 3 orë nga momenti i procesimit ose plotësimit të urdhër pagesës për transaksionin. EasyPay brenda 10 ditë pune do të kthejë një përgjigje në lidhje me kërkesën ku në rast të pamundësisë së rimbursimit do të paraqesë arsyet dhe autoritetet ose subjektet ku klienti mund të ankohet dhe të ndjekë më tej çështjen.

Në rast të kryerjes së pagesës elektronike me përdorimin e Kartave të Debitit/ Kreditit, Klienti duhet të kontaktojë menjëherë Shërbimin për Klientët e ofruesit të kartës për kërkesë anulimi transaksioni. Për të filluar anulimin e transaksionit është e domosdoshme që shumica e transaksionit që kërkohet të anulohet të jetë plotësisht dhe jo pjesërisht e kthyeshme.

Pasi kanë përfunduar verifikimet e nevojshme mbi kërkesën e paraqitur për anulim transaksioni, EasyPay ose Banka përkatëse lëshuese e kartës, komunikon me Klientin dhe departamentet përkatëse për kryerjen e procedurës së anulimit të transaksionit dhe rikthimit të fondeve të Klientit në llogarinë EasyPay, ose në llogarinë e tij bankare të mbajtur në bankën lëshuese të kartës.

Në rast të një ndodhie përtej kontrollit të arsyeshëm të secilës Palë të përfshirë në këtë marrëveshje, përgjegjësitë do të kalojnë tek Partneri i EasyPay i cili organizon eventin ose ofron shërbimin ose produktin. Nëse Partneri EasyPay mundëson rimbursimin sipas kërkesës për anulim, EasyPay do të sigurohet që fondet e paguara nga Klienti të rikthehen në vlerë të plotë në llogarinë EasyPay të Klientit, ose në llogarinë e tij bankare të mbajtur në bankën lëshuese të kartës. EasyPay nuk mban përgjegjësi në rimbursim në rast anulimi nëse Partneri EasyPay nuk e mundëson shërbimin e

anullimit të pagesës ose blerjes sipas kushteve të dakortësuara nga klienti në momentin e blerjes apo pagesës. Në këtë rast klienti pranon se nuk do të bëjë përgjegjës EasyPay.

9. Siguria dhe përdorimi i paautorizuar

Llogaria e Klientit EasyPay mund të aksesohet vetëm me kredencialet e krijuara në momentin e regjistrimit ose përditësimit nga ana e klientit (i. fjalëkalim me jo më pak se 8 karaktere nga të cilat të paktën një numer dhe karakter special; ii. "Username" unik i përzgjedhur nga vetë klienti; iii. adresa e postës elektronike (e-mail) / numër kontakti, regjistruar nga vetë klienti;) është e lidhur me vetëm një 'Fjalëkalim të personalizuar' dhe një adresë poste elektronike (e-mail) të përcaktuara nga Klienti EasyPay në momentin e regjistrimit. Vetëm Klienti mund të përdorë këtë 'Fjalëkalim' online ose dhe inputimin e tyre në Aplikacionin EasyPay në pajisjen celulare për të aksesuar dhe përdorur Llogarinë EasyPay. Aksesimi në Llogarinë e parasë elektronike në aplikacionin EasyPay i lejohe vetëm klientit dhe askujt tjetër. Klienti ka përgjegjësi për ruajtjen dhe përdorimin e përshtatshëm të pajisjes celulare apo për përdorimin e llogarisë online (web), dhe për ruajtjen në mënyrë të sigurt të 'Fjalëkalim-it'.

Klienti EasyPay ka detyrimin të njoftojë menjëherë EasyPay në lidhje me ndryshimet në të dhënat personale të lidhura me llogarinë e tij/ saj EasyPay.

Klienti duhet të njoftojë menjëherë Shërbimin EasyPay në numrin 00355 42 264 982 ose në adresën e email info@easypay.al në rast materializimi të një prej ngjarjeve të mëposhtme:

- Janë kryer transaksione pa dijeni dhe pa miratim të Klientit;
- Ka gabime apo mospërputhje në balancën e Klientit;
- Të dhënat e aksesimit të llogarisë EasyPay janë keqpërdorur, humbur, kopjuar;
- Vihet re një mashtrim apo abuzim në lidhje me llogarinë EasyPay të Klientit.

Në rast keqpërdorimi, humbjeje aksesit, kopjimi të të dhënave të aksesimit të llogarisë EasyPay, Klienti ka detyrimin të njoftojë menjëherë EasyPay në lidhje me rastin ose të kërkojë pezullimin e Shërbimeve EasyPay.

Për të gjitha tarifat e aplikuara dhe transaksionet e kryera deri në marrjen e njoftimit nga ana e Klientit, përgjegjësia mbi veprimet e kryera bie mbi Klientin dhe EasyPay nuk do të ngarkohet me përgjegjësi për këto tarifa dhe transaksione. Klienti rezervon të drejtën e dëmshpërblimit nga EasyPay ndaj pretendimeve të ngritura në lidhje me tarifa dhe transaksione të kryera me llogarinë EasyPay vetëm dhe ekskluzivisht pas marrjes së njoftimit nga ana e EasyPay për rastin e keqpërdorimit, humbjes së aksesit apo kopjimit të të dhënave të aksesimit të llogarisë EasyPay.

Kur klienti mohon të ketë autorizuar ekzekutimin e një transaksioni pagese ose pretendon se transaksioni i pagesës nuk është ekzekutuar në mënyrë korrekte, është detyrë e EasyPay që të provojë se transaksioni i pagesës është autentifikuar, regjistruar me saktësi, është kontabilizuar dhe nuk është cenuar nga ndonjë defekt teknik ose nga ndonjë mangësi tjetër e shërbimit të ofruar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave si dhe të dhëna të tjera që provojnë që klienti mund të jetë mashtruar ose të jetë treguar pakujdesi.

10. Produktet dhe Çmimi

Çdo informacion në lidhje me përshkrimin e produkteve e pagesave, karakteristikat e tyre dhe çmimet apo komisionet do të shfaqen me specifika të detajuara në:

- Faqen e internetit www.easypay.al. Çmimet e përcaktuara në faqen e internetit të EasyPay janë çmimet neto me TVSH;
- Nëpërmjet email automatik në adresat e kontaktit të deklaruara në momentin e regjistrimit dhe sa here që ka ndryshime të tarifave ose listë së shërbimeve dhe produkteve.
- Në dokumentin e shkarkuar të termave dhe kushteve gjatë regjistrimit në aplikacionin EasyPay;
- Gjatë përzgjedhjes së shërbimit në aplikacionin EasyPay, para procesimit të transaksionit;
- Pranë çdo pike EasyPay nëpërmjet fletëpalosjeve.

EasyPay vendos në dispozicion të klientit të parasë elektronike si pjesë të kontratës listën e shërbimeve dhe tarifave përcaktuara në aneksin "Dokument që përmban informacion mbi tarifat".

Klientët kanë të drejtën të njihen me mënyrën e përdorimit apo çdo informacion tjetër që shoqëron produktet e shërbimit e listuara dhe në çdo moment mund të kontaktojnë EasyPay për sqarime të mëtejshme në adresat e kontaktit ose pranë çdo pike EasyPay. Në rast gabimi në shkrim në lidhje me çmimet e një apo disa shërbimeve apo produkteve, EasyPay do t'ia njoftojë gabimin Klientit. Klienti është i lirë të zgjedhë për vazhdimin e transaksionit deri në fund apo ndërprerjen e tij.

Sidoqoftë, në lidhje me produktet/ shërbimet e ofruara/ komercializuara nga të tretët nëpërmjet platformës EasyPay,

EasyPay nuk ka asnjë kontroll mbi këto produkte/ shërbime dhe, si rrjedhim, nuk ofron asnjë garanci në lidhje me to (cilësinë apo ekzistencën e tyre).

11. Konfirmimi i Pagesës

Pas përfundimit të kryerjes së pagesës nëpërmjet përdorimit të Aplikacionit EasyPay ose nëpërmjet faqes zyrtare të internetit www.easypay.al për blerjen e produktit (-eve) apo shërbimit (-eve), EasyPay i konfirmon Klientit menjëherë pagesën. Përveç kësaj, Klienti do të marrë një mesazh nëpërmjet postës elektronike të tij, i cili konfirmon pagesën në rrugë elektronike dhe përmban informacionin mbi shërbimin/ produktin, sasinë, çmimin dhe numrin unik të transaksionit. Pagesa e Klientit do të konsiderohet e pranuar vetëm pas konfirmimit të saj nga EasyPay. Porosia e Klientit mund të rishikohet nga EasyPay, dhe konsultohet me Klientin në rast paqartësie.

12. Mënyrat e Kryerjes së Pagesës

Klienti mund të kryejë pagesën me:

- (i) Pagesë nëpërmjet përdorimit të Aplikacionit EasyPay;
- (ii) Pagesë online nëpërmjet përdorimit të llogarisë EasyPay;
- (iii) ose Pagesë online me mjetet e tjera të pagesave elektronike të listuara në faqen zyrtare të EasyPay: www.easypay.al
- (iv) Kartë bankare debiti ose krediti (e çdo lloji).

Vini Re:

- Në rastin e pagesave me kartë debiti ose krediti (e çdo lloji), gjatë kryerjes së pagesës, Klienti lidhet automatikisht me serverin e pagesave, pjesë e sistemit të kontrollit të qendrës së përpunimit të të dhënave të bankës. Të dhënat bankare të Klientit, të mbrojtura nëpërmjet enkriptimit, nuk kalojnë nëpërmjet sistemeve elektronike të EasyPay dhe nuk ruhen në sistemet elektronike të EasyPay.
- Në rastin e pagesave nëpërmjet përdorimit të llogarisë elektronike EasyPay, gjatë kryerjes së pagesës, Klienti lidhet automatikisht me serverin e pagesave të EasyPay dhe të dhënat e Klientit personale apo sensitive, ruhen nga elementë sigurimi të enkriptuar dhe përdoren në përputhje të plotë me Ligjin nr.124/2024, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

13. Përdorimi i të Dhënave Personale: EasyPay zbaton rigorozisht të gjithë kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale veçanërisht Ligjin nr.124/2024, datë "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" si dhe aktet nënligjore përkatëse.

Të dhënat personale mbrohen nëpërmjet kredencialeve të krijuara për aksesin në platformën EasyPay.

Gjithashtu për mbrojtjen e të dhënave të klientit, EasyPay implementon një sërë procedurash dhe sisteme kontrolli dhe parandalimi të sulmeve kibernetike apo shpërndarjes së pa autorizuar të të dhënave. Nëse Klienti mendon ose dyshon se llogaria e tij mund të përdoret nga të tretë të paautorizuar, Klienti duhet të njoftojë menjëherë EasyPay.

Klienti ka të drejtën e informimit, aksesit, korrigjimit, fshirjes, harrimit, kufizimit të përpunimit të të dhënave të tij personale ose kundërshtimit të përpunimit të tyre si dhe transferimit të dhenave të tij personale te një kontrollues tjetër.

Klienti mund të ushtrojë këto të drejta duke shkruar në email: dpo@easypay.al. ose me shkresë zyrtare drejtuar EasyPay Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO) në adresën "Rruga Vëllezërit Hobdari, Godina Nr 15, Tiranë."

EasyPay mbledh dhe përpunon të dhëna në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm vetëm nëse Klienti ka dhënë pëlqimin e tij ose nëse është e nevojshme:

- i. për interesat e saj legjitime;
- ii. për të përmbushur detyrimet e saj kontraktore,
- ose
- iii. për të përmbushur një detyrim ligjor

EasyPay nuk do t'i mbajë të dhënat e Klientit për më gjatë se sa është e përcaktuar në ligj dhe akte nënligjore. Klienti pranon dhe autorizon EasyPay që për realizimin e qëllimit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale që burojnë nga kjo kontratë, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare të tij, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 124/2024, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" në fuqi.

14. Pronësia Intelektuale

Faqja e internetit www.easypay.al dhe Aplikacioni EasyPay janë ekskluzivisht të ndërtuar nga EasyPay Sh.p.k. Të gjithë elementët e përdorur në këtë faqe dhe në këtë Aplikacion, duke përfshirë elementë vizualë apo zanorë, përfshirë teknologjinë bazë, janë të mbrojtura nga e drejta e autorit, marka tregtare ose patenta. Ato janë në pronësinë ekskluzive të shoqërisë EasyPay Sh.p.k. Kjo faqe dhe ky Aplikacion përdoren sipas Kushteve të Përgjithshme që përcaktohen shprehimisht këtu dhe Klienti, në asnjë mënyrë nuk mund të fshijë, çënojë ose modifikojë çfarëdolloj *copyright*, markë tregtare të regjistruar apo jo apo shenjë dalluese, në çfarëdolloj forme, që i përket EasyPay dhe është vizualizuar prej saj në faqen zyrtare ose në Aplikacion.

15. Ndryshime të Kushteve, Afateve dhe Tarifave

EasyPay rezervon të drejtën të ndryshojë në çdo kohë këto Kushte, Afate dhe Tarifa. Këto ndryshime do t'i njoftohen Klientit jo më vonë se 2 muaj përpara datës së propozuar për fillimin e zbatimit të tyre, me anë të një njoftimi në adresën e e-mail të Klientit të lidhur me Shërbimin EasyPay, ose nëpërmjet faqes zyrtare së internetit të EasyPay. Klienti mund të pranohet ose të refuzojë ndryshimet përpara datës së propozuar të hyrjes së tyre në fuqi. Me kalimin e afatit të njoftimit, Klienti do të konsiderohet se është njoftuar për këto ndryshime.

Në rast ndryshimesh, ato nuk do të kenë fuqi prapavepruese. Për oferta të veçanta që kanë kushte shtesë, do të komunikohen dhe publikohen në rastin e ofrimit të tyre në www.easypay.al. Nëse Klienti nuk është dakord me një nga ndryshimet, atëherë ai/ ajo nuk duhet të vazhdojë të kryejë transaksione me EasyPay dhe duhet të komunikojë me EasyPay ose të paraqitet pranë një Agjenti EasyPay për të kërkuar zgjidhjen e Marrëveshjes së shërbimit me EasyPay brenda afatit të njoftimit të ndryshimit ose të disinstalojë Aplikacionin, përndryshe do të konsiderohet se i ka pranuar këto ndryshime.

16. Pasqyra e veprimeve të llogarisë

Klientët e regjistruar në EasyPay mund të informohen për gjendjen e llogarisë së tyre EasyPay dhe të kërkojnë informacion për transaksionet e kryera në këto mënyra:

- (i) Nga aparati i tyre celular dhe Aplikacioni EasyPay Klienti mund të shohë në çdo kohë Pasqyrën e Llogarisë së tij me informacionin në lidhje me shumat e debituar dhe të kredituar transaksioneve të kryera.
- (ii) Duke telefonuar Shërbimin EasyPay për Klientin në numrin 00355 42 264 982. Klienti duhet të japë informacionin e kërkuar nga Shërbimi i Klientit për verifikimin e tij si mbajtës i Llogarisë për të cilën po kërkohet informacion mbi balancën dhe transaksionet e kryera.
- (iii) Duke vizituar një prej Agjentëve EasyPay për të paraqitur kërkesë për Pasqyrën e Transaksioneve. Plotësimi i kërkesës kryhet në dyqan dhe Pasqyra e Transaksioneve tërhiqet përsëri në të njëjtin dyqan brenda një harku kohor prej 7 (shtatë) ditësh pune dhe pas marrjes së njoftimit nëpërmjet një telefonate konfirmuese nga Shërbimi i Klientit EasyPay.
- (iv) Duke kontaktuar në adresën e email info@easypay.al
- (v) EasyPay vendos në dispozicion klientit të parasë elektronike, përmes adresave të postës elektronike ose në aplikacionin/platformat EasyPay (të paktën një herë në vit), një pasqyrë të të gjitha tarifave të aplikuar.

17. Mosfunksionim apo keqfunksionim i pajisjeve dhe garanci të tjera

EasyPay nuk është përgjegjëse për humbje që lindin për shkak të mosfunksionimit, keqfunksionimit apo vonësive në rrjetet e komunikimeve elektronike, pajisjeve celulare apo pajisjeve të tjera fundore, që rezultojnë nga rrethana përtej kontrollit të arsyeshem të EasyPay.

Klienti merr përsipër çfarëdolloj rreziku në lidhje me Aplikacionin EasyPay dhe mban ekskluzivisht përgjegjësinë për dëmet eventuale që mund të shkaktohen nga shkarkimi dhe përdorimi i Aplikacionit EasyPay.

Aplikacioni EasyPay dhe shërbimet përkatëse ofrohen "ashtu si janë" dhe në "kufijtë e disponibilitetit". Përveçse çfarë parashikon ligji në mënyrë të paderogueshme, EasyPay nuk jep garanci të tjera eksplicite ose implicite në lidhje me shërbimet e saj.

Klienti merr përsipër ta mbajë të pacënuar dhe të dëmshpërblejë EasyPay për çdo dëm ose pretendim të ngritur nga të tretët kundrejt EasyPay për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të Klientit.

18. Njoftimet

EasyPay ka të drejtë të dërgojë tek Klienti EasyPay informacion dhe njoftime në lidhje me këto Kushte dhe Afate dhe në lidhje me shërbimet EasyPay përmes mesazheve në aparatin celular, postës elektronike si dhe mjeteve të tjera të komunikimit dhe në adresat që Klienti ka vendosur në dispozicion në momentin e regjistrimit në EasyPay. Në çdo fushatë promovionale për lançimin e një shërbimi të ri apo ndryshime në shërbime ekzistuese, EasyPay ka të drejtë të dërgojë postë elektronike (e-mail) notifikuese tek Klientët EasyPay në lidhje me shërbimet e reja.

Me aprovimin nga Klienti, Klienti EasyPay njoftohet në mënyrë periodike për detyrime të papaguara dhe mënyrat e pagesës së tyre.

Nëse Klienti EasyPay nuk dëshiron të marrë mesazhe notifikuese apo promovuese, atëherë Klienti duhet të kontaktojë me EasyPay dhe të parashtrojë kërkesën përkatëse në adresën: EasyPay Sh.p.k., Rruga Vëllezërit Hobdari, Godina Nr 15, Tiranë ose duke kontaktuar Shërbimin për Klientët EasyPay në numrin 00355 42 264 982 ose sipas ndryshimeve në adresat e kontaktit që do të bëhen të ditura herë pas here.

Klienti merr përsipër që të dhënat e kontaktit, të jenë të përditësuara dhe se Klienti mund të arrihet nga këto detaje kontakti. Nëse të dhënat e kontaktit duhet të ndryshojnë, atëherë Klienti është i detyruar njoftojë Shërbimin e Klientit EasyPay duke kontaktuar në adresën e email info@easypay.al për përditësimin e detajeve të kontaktit.

19. Kufizimi i Përgjegjësi EasyPay nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjet që Klienti mund të pësojë gjatë përdorimit të shërbimeve EasyPay, përveç rasteve nëse këto janë shkaktuar kur:

- (i) Transaksioni nuk është ekzekutuar ose është ekzekutuar gabim për shkak të EasyPay.
- (ii) Transaksioni nuk është autorizuar nga Klienti,
- (iii) si dhe për gabime apo pasaktësi të shkaktuara nga EasyPay, në lidhje me mbajtjen e Llogarisë EasyPay të Klientit.

Mbulimi i detyrimeve financiare sipas parashikimeve më sipër, përfshin vetëm:

- (i) Vlerën e transaksionit të paekzekutuar ose të ekzekutuar gabim.
- (ii) Shumën e nevojshme për të rikthyer Llogarinë EasyPay të Klientit në gjendjen e mëparshme.

EasyPay nuk mban përgjegjësi ndaj Klientëve për dëmet indirekte që mund të vijnë si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të palëve të treta të lidhura me EasyPay për arsye të parashikimeve kontraktore apo ligjore.

20. Mbyllja e Llogarisë EasyPay:

Mbyllja e Llogarisë EasyPay mund të kryhet si më poshtë:

- (i) Klienti në formë shkresore kërkon zgjidhjen e Kontratës të nënshkruar me EasyPay Sh.p.k. Kjo shkresë mund të dorëzohet pranë cdo Agjenti EasyPay. Klienti duhet të garantohet të tërheqë/ përdorë të gjithë balancën e disponueshme në Llogarinë e tij EasyPay, përpara mbylljes së Llogarisë EasyPay. EasyPay do të mbyllë Llogarinë e Klientit brenda 5 (pesë) ditë pune me marrjen e njoftimit nga Klienti EasyPay.
- (ii) EasyPay: Në rastet e kryerjes së veprimtarive në mospërputhje me Kushtet dhe Afatet e vendosura shprehimisht në këtë dokument ose në rastet e kryerjes së veprimtarive të paligjshme me Llogarinë EasyPay nga ana e Klientit si edhe në rastet me kërkesë nga Autoritetet përkatëse Ligj zbatuese, EasyPay rezervon të drejtën, të pezullojë dhe/ ose bllokojë Llogarinë tuaj EasyPay dhe/ ose bllokojë fondet e disponueshme në këtë Llogari.

Për të tërhequr fondet e një llogarie të mbyllur EasyPay, por me balancë të disponueshme në momentin e mbylljes, Klienti duhet të vizitojë një nga Agjentët EasyPay për të paraqitur kërkesë me shkrim për Tërheqjen e Fondeve. Plotësimi i kërkesës kryhet në dyqan dhe pas miratimit së kërkesës brenda një afati kohor prej 7 (shtatë) ditësh pune, fondet kalojnë përmes një transfertë në numrin e Llogarisë të paraqitur nga Klienti në Formën e Tërheqjes së Fondeve.

21. Vlefshmëria

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e Nënshkrimit të saj. Secila nga Palët rezervon të drejtën ligjore për të kërkuar zgjidhjen e njëanshme të Kontratës në përputhje me parashikimet e saj duke dhënë një njoftim paraprak me shkrim ndaj Palës tjetër 30 (tridhjetë) ditë përpara.

22. Juridiksioni dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Këto Kushte dhe Afate janë në përputhje me Legjislacionin shqiptar. Mosmarrëveshjet e mundshme që mund të lindin midis Palëve gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje do të zgjidhen nga gjykata kompetente shqiptare.

23. Shërbimi i Klientit

Nëse keni pyetje, ankesa ose vërejtje rreth këtyre Kushteve të Përgjithshme ose pagesës tuaj në rrugë elektronike në faqen e internetit të EasyPay Sh.p.k., ju lutemi të na kontaktoni me e-mail në info@easypay.al ose në numrin e suportit të Klientit: 00355 42 264 982.

24. Pranimi i Kushteve dhe Afateve nga Klienti

Klienti dhe përdoruesi i Shërbimeve EasyPay i njëj plotësisht Kushtet dhe Afatet e sipër-cituara dhe i pranon ato pa rezerva. Klienti dhe përdoruesi i Shërbimeve EasyPay pranon se ka lexuar dhe i janë bërë të ditura Kushtet, Afatet dhe Tarifat e Shërbimeve EasyPay, si dhe është njohur me mënyrën e ndryshimit të tyre dhe i pranon ato pa rezerva.

25. Të ndryshme:

Kjo Kontratë e cila përfshin Formën e Kërkesës për Regjistrim për Përdorimin e Shërbimeve EasyPay, Kushtet dhe Afatet e Përdorimit të Shërbimeve EasyPay dhe Anekset përkatëse të bashkëlidhura, dhe ndryshimet e saj herë pas here, përbën marrëveshjen e plotë e të detyrueshme nga ana ligjore, për klientin EasyPay dhe për EasyPay.

Kjo Kontratë nuk mund t'i kalohet apo transferohet asnjë personi tjetër.

Të gjithë elementët e përdorur në faqen e internetit www.easypay.al dhe në Aplikacionin EasyPay janë në pronësinë ekskluzive të EasyPay dhe të mbrojtura nga e drejta e autorit, marka tregtare ose patenta.

Kjo Kontratë dhe anekset e saj përpilohen në 2 (dy) kopje origjinale, të cilat kanë të njëjtën përmbajtje në gjuhën Shqipe, nga të cilat 1 (një) kopje mbahet nga EasyPay dhe 1 (një) mbahet nga Klienti EasyPay. Të dy ekzemplarët nënshkruhen nga palët fizikisht ose elektronikisht.

Nënshkrimi elektronik mund të kryhet nëpërmjet aplikacionit ose në një mjedis tjetër online. Palët bien dakord dhe pranojnë se të gjitha deklaratat në lidhje me Aplikimin, lidhjen, zbatimin dhe përfundimin e Kontratës, të nënshkruara me një nënshkrim elektronik të avancuar do të jetë e barasvlershme ligjërisht me një nënshkrim të nënshkruar me dorë.

**Institucioni i Parasë Elektronike
EasyPay SHPK**
Klienti

(Emër, Mbiemër i Personit të Autorizuar,

(Emër, Mbiemër i Personit të Autorizuar,

Nënshkrimi dhe vula)

Nënshkrimi)

Klienti EasyPay SHPK:

- Jam njohur me dhe kam pranuar secili prej dhe të gjithë këtyre Kushteve dhe Afateve të Përgjithshme në këtë dokument.
- Në mënyrë të posaçme dhe veçmas, miratoj shprehimisht Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 11, 13, 15, 17, 18, 19, 22, 23 të Kushteve dhe Afateve të Përgjithshme.

**Institucioni i Parasë Elektronike
EasyPay SHPK**
Klienti

(Emër, Mbiemër i Personit të Autorizuar,

(Emër, Mbiemër i Personit të Autorizuar,

Nënshkrimi dhe vula)

Nënshkrimi)

Data e nënshkrimit: ____/____/____

ANEKSI I – LIMITET¹ PËR KRYERJEN E TRANSAKSIONEVE NËPËRMJET SHËRBIMIT EASYPAY**A) Limitet Ditore**

Limite Ditore						
Kategoria e klientit	(1) Vlera maksimale e rimbushjeve të balancës së Llogarisë IPE nëpërmjet të gjitha kanaleve të rimbushjeve	(2) Vlera maksimale Erimbushjeve të balancës së Llogarisë IPE nëpërmjet Pikës EasyPay	(3) Vlera maksimale e total transaksioneve për shërbimet e ofruara nga EasyPay	(4) Vlera Maksimale ditore për tërheqje të balancës nga llogaria IPE	(5) Vlera Maksimale e total transaksioni eve P2P (transfertë ne nisje)	(6) Vlera Maksimale e total transaksioni eve P2P (transfertë ne mbërritje)
Niveli 1	0Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek
Niveli 2	99,999 Lek	30,000 Lek	99,999 Lek	10,000 LEK	20,000 Lek	20,000 Lek
Niveli 3	200,000 Lek	50,000 Lek	200,000 Lek	20,000 LEK	20,000 Lek	20,000 Lek

B) Limitet Mujore

Limite Mujore						
Kategoria e klientit	(1) Vlera maksimale e rimbushjeve të balancës së Llogarisë IPE nëpërmjet të gjitha kanaleve të rimbushjeve	(2) Vlera maksimale e rimbushjeve të balancës së Llogarisë IPE nëpërmjet Pikës EasyPay	(3) Vlera maksimale e total transaksion eve për shërbimet e ofruara nga EasyPay	(4) Vlera Maksimale e total transakison eve të tërheqjes të balancës nga llogaria IPE	(5) Vlera Maksimale e total transaksioni eve P2P (transfertë ne nisje)	(6) Vlera Maksimale e total transaksionieve P2P (transfertë ne mbërritje)
Niveli 1	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek
Niveli 2	200,000 Lek	100,000 Lek	300,000 Lek	100,000 LEK	50,000 Lek	50,000 Lek
Niveli 3	300,000 Lek	150,000 Lek	400,000 Lek	150,000 LEK	50,000 Lek	50,000 Lek

C) Limitet Vjetore

Limite Vjetore						
Kategoria e klientit	(1) Vlera maksimale e rimbushjeve të balancës së Llogarisë IPE nëpërmjet të gjitha kanaleve të rimbushjeve	(2) Vlera maksimale e rimbushjeve të balancës së Llogarisë IPE nëpërmjet Pikës EasyPay	(3) Vlera maksimale e total transaksioneve për shërbimet e ofruara nga EasyPay	(4) Vlera Maksimale e total transakisone ve të tërheqjes të balancës nga llogaria IPE	(5) Vlera Maksimale e total transaksioni e ve P2P (transfertë ne nisje)	(6) Vlera Maksimale e total transaksioni eve P2P (transfertë ne mbërritje)
Niveli 1	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek	0 Lek
Niveli 2	500,000 Lek	200,000 Lek	500,000 Lek	200,000 LEK	200,000 Lek	200,000 Lek

Niveli 3	999,999 Lek	300,000 Lek	999,999 Lek	250,000 LEK	200,000 Lek	200,000 Lek
----------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------	-------------

D) Limite te Tjera

Kategoria e klientit	(1) Vlera Maksimale e Balancës së Parasë Elektronike	(3) Vlera minimale për një rimbushje llogarie	(4) Vlera Minimale e Balancës IPE	(5) Vlera Maksimale e një transaksion tërheqje për mbyllje llogarie IPE1
Niveli 1	0 Lek	Nuk aplikohet	0 Lek	10,000 Lek (ose më shumë me aprovim paraprak)
Niveli 2	100,000 Lek	1000 Lek	0 Lek	50,000 Lek (ose më shumë me aprovim paraprak)
Niveli 3	200,000 Lek	1000 Lek	0 Lek	100,000 Lek (ose më shumë me aprovim paraprak)

Nivelet e Klientit EasyPay:

Kategoria e klientit	Shpjegimi mbi kategorinë e klientit	Shpjegimi mbi kategorinë e klientit
Niveli 1 (Klient i thjeshtë)	Në këtë Nivel ndodhet çdo klient i cili: - ka kryer regjistrimin fillestar nëpërmjet platformave / aplikacionit EasyPay; - ka vendosur në dispozicion të gjithë të dhënat e nevojshme (përfshirë të dhënat identifikuese) si dhe dokumentacionin e nevojshëm, të cilat janë të detyrueshme për plotësim sipas Formatit të Regjistrimit për Përdorimin e Shërbimeve EasyPay; - Ka lexuar dhe ka pranuar kushtet e kontratës TIP për shërbimet IPE të EasyPay; - Është verifikuar nëpërmjet kontaktit me email ose telefon pas regjistrimit të kryer nga stafi i dedikuar EasyPay.	cili: - tar nëpëhë të - on të gjitionir - mentac rimit - ë Regjist e ko - kushtet tit n - et konta
Niveli 2 (Klient Standard)	Në këtë Nivel ndodhet: - Çdo klient i Nivelit 1 që është identifikuar dhe verifikuar elektronikisht dhe ose me prezencë fizike pranë një pike EasyPay si dhe ka nënshkruar dokumentin e kushteve të shërbimit duke përfshirë miratimin nëpërmjet nënshkrimit të kontratës TIP të lexuar dhe pranuar paraprakisht gjatë krijimit të llogarisë IPE - Çdo klient i Nivelit 3 që ka kryer rimbushje të llogarisë me më shumë se 3 (tre) karta bankare të ndryshme në 6 (gjashtë) muajt e fundit ulet në Nivel 2. - Çdo klient i Nivelit 3 për të cilin është marre vendim nga EasyPay për ndryshimin e kategorisë nga Nivelit 3 në Nivelin 2.	shtë ide - rtifik - pike EasyPay - miratimin në - gjatë krijimi - a kryer rimbushje 6 (gjashtë) m - ë cilin është - ë Nivelin 2.
Niveli 3 (Klient i avancuar)	Në këtë Nivel ndodhet: - Çdo Klient EasyPay i cili b - klient i Nivelit 2 ka mbush - ndryshme dhe ka kryer nj - m'nal' ht 2 (transaksione) pagesash; - minimalisht 2 (transaksione) pagesash; - Çdo Klient i Nivelit 2 i cili brenda nj - madhe ose baraz me 300,000 Lek - Çdo Klient i Nivelit 2 me miratim paraprak të EasyPay, i cili dërgon kërkesë me shkrim në kanalet zyrtare të komunikimit duke sqaruar në mënyrë të arsyeshme nevojën për limite më të larta transaksionale.	renda një pe - ur lloga rinë - ë minimum p n) 373.3.4 - ë pagesat - li brenda një ,000 Lek e n - niratim parap - ikimit du ke s - e.²

¹ Të gjithë vlerat e Limiteve janë të shprehura në monedhën Lekë.

² EasyPay rezervon të drejtën që brenda 48 orësh, nga lajmërimi nëpërmjet adresave të kontaktit të rikategorizojë klientin në Nivel 2.

ANEKSI II:DOKUMENT QË PËRMBAN INFORMACION MBI TARIFAT

Shërbimi	Tarifa
Shërbimi	Tarifa
Shërbime të përgjithshme të llogarisë	
Hapja e nje llogarie	Falas
Mirëmbajtje llogarie	Falas
Pagesat	
Debitim direkt	n/a
Pagesa periodike	n/a
Transfertat	
Transfertat ne nisje	
Transferta në nisje brenda Shqipërisë nëpërmjet platformës online	Falas
Transferta në nisje jashtë Shqipërisë nëpërmjet platformës online	n/a
Transferta në nisje jashtë Shqipërisë në degë	n/a
Transferta në nisje brenda Shqipërisë në degë	n/a
Transferta ne mbërritje	
Transferta në mbërritje brenda Shqipërisë	Falas
Transferta në mbërritje jashtë Shqipërisë	n/a
Kartat dhe tërheqjet në para fizike	
Tërheqja e fondeve në para fizike brenda Shqipërisë nëpërmjet kartës së debitit	n/a
Tërheqja e fondeve në para fizike jashtë Shqipërisë nëpërmjet kartës së debitit	n/a
Pagesa me kartë debiti brenda Shqipërisë	n/a
Pagesa me kartë debiti jashtë Shqipërisë	n/a

Pagesa me kartë krediti brenda Shqipërisë	n/a
Pagesa me kartë krediti jashtë Shqipërisë	n/a
Kredi kufi dhe shërbimet përkatëse	
Kredi kufi/overdraft per klientët	n/a

Rruga "Ismail Qemali"

Objekti Nr.30, Hyrja 7, Kati 3

Tiranë, Shqipëri